

TCL 20_L

**Siguria dhe informacionet e
garancisë**



www.sar-tick.com

Ky produkt është në përputhje me limitet SAR prej 2,0 W/kg për kokën the trupin, dhe 4,0 W/kg për gjymtyrët. Vlerat specifike maksimale SAR mund të gjenden në pjesën **Valët e radios**.

Gjate mbajtjes ose perdorimit prane trupit tuaj perdorni një aksesor të aprovuar, si p.sh. këllëf, ose përndryshe mbajeni në një distancë 5 mm nga trupi për të siguruar pershtatjen me kërkesat për ekspozimin ndaj radiofrekuencave. Kini parasysh se produkti mund të jetë duke transmetuar edhe nëse nuk jeni duke kryer thirrje.



MBROJTJA E DËGJIMIT

Për të parandaluar dëmtimin e mundshëm të dëgjimit, mos dëgjoni në nivele të larta volumi për periudha të gjata. Kini kujdes kur mbani telefonin afër veshit ndërkohë që altoparlanti është në përdorim.



MBRONI SYTË TUAJ

TCL 20L ka marrë certifikimin TÜV Rheinland për emetimin e ulët të dritës blu. Aktivizimi i modalitetit të rehatisë së syve mund të pakësojë dritën e dëmshme blu që del nga ekrani, duke i mbrojtur sytë tuaj gjatë shikimit për kohë të gjatë.



TCL 20L ka marrë certifikimin TÜV Rheinland për dritën polarizuese rrethore. Ekranin e smartfonëve mund të emetojë dritë të polarizuar rrethore, një dritë të ngjashme me dritën natyrale, e cila mund të pakësojë lodhjen e syve gjatë shikimit për kohë të gjatë.



TCL 20L ka marrë certifikatën Hi-Res Audio. Hi-Res Audio ju jep cilësi audio që e tejkalon atë të CD-së, dhe është pranë cilësisë së regjistrimit në studio.

Njoftim:

Audio me rezolucion të lartë ka nevojë për një kufje të pajtueshme. Mund të jetë e nevojshme të blini kufje me certifikimin Hi-Res Audio.

Siguria dhe përdorimi

Para përdorimit të telefonit tuaj ju rekomandojmë të lexoni me kujdes këtë kapitull. Prodhuesi nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për dëmin, që mund të rezultojë si pasojë e përdorimit të papërshtatshëm ose përdorimit në kundërshtim me udhëzimet e përfshira këtu.

• SIGURI TRAFIKU

Duke pasur parasysh se studimet tregojnë se duke përdorur një telefon celular, ndërsa ngisni automjetin përbën një rrezik të vërtetë, madje edhe kur është përdorur pajisja handsfree (pajisje makine, kufje ...), shoferëve u kërkohet që të shmangin përdorimin e celularit të tyre kur automjeti nuk është i parkuar. Gjatë drejtimit, mos përdorni telefonin tuaj dhe kufjet për të dëgjuar muzik ose radion. Përdorimi i kufjeve të telefonit mund të jetë i rrezikshëm ose i ndaluar në disa zona.

Kur telefoni juaj është i ndezur, lëshon vale elektromagnetike që mund të ndërhyjnë në sistemin elektronik të automjetit të... sic është ABS(anti bllokimi i frenave) ose AIRBAG(jastek ajri) Për tu siguruar që nuk ka asnjë problem:

- Mos vendosni telefonin tuaj sipër panelit të aparaturave ose brënda zonës së shpërndarjes së jastëkëve të ajrit,
- Pyesni tregtarin e makinës ose prodhuesin e makinës për t'u siguruar që paneli i aparaturave është i mbrojtur në mënyrë adekuate nga energjia RF e pajisjes.

• KUSHTET E PËRDORIMIT

Këshillojmë të fikni telefonin herë pas here për të rregulluar performancën e tij.

Fikni telefonin tuaj para se te hipni ne aeroplan.

Fikni telefonin kur jeni në ndërtesa të kujdesit shëndetësor, me përjashtim të zonave të caktuara. Sic ndodh me shume pajisje që përdoren shpesh, telefonat celularë mund të bashkeveprojn me pajisje të tjera elektrike ose elektronike, ose pajisje që përdorin radio frekuenca.

Ju lutemi konsultohuni me mjekun dhe prodhuesin e pajisjes për të përcaktuar nëse përdorimi i telefonit mund të interferojë me përdorimin e pajisjes suaj mjekësore.

Fikni telefonin kur jeni pranë gazit ose lëngjeve të ndezshme. Binduni rrëptësisht të gjitha shenjave dhe udhëzimeve të afishuara në një depo karburanti, stacion karburanti ose fabrikë kimike ose në ndonjë ambient potencialisht shpërthyes.

Fikeni telefonin celular ose pajisjen me valë kur jeni në një zonë shpërthimi ose në zona në të cilat janë vendosur tabela, në të cilat kërkohet që "radiot dy-drejtimëshe" ose "pajisjet elektronike" të fikën për të shmangur interferencat me operacionet e shpërthimit.

Kur telefoni është i ndezur, ai duhet të mbahet të paktën 15 cm nga çdo pajisjeje mjekësore të tillë si një stimulues kardiak, një aparat dëgjimi ose pompë insuline, etj. Në veçanti kur përdorni telefonin, ju duhet ta mbani atë kundër veshit në anë të kundërt të pajisjes, nëse ka ndonjë.

Për të shmangur demtimin e dëgjimit, pergjigjuni thirjes përpara se të vini telefonin në vesh. Gjithashtu lëvizni telefonin larg nga veshi juaj duke përdorur regjimin "handsfree (pa duar)" sepse përforsimi i volumit mund të shkaktojë dëme të dëgjimit.

Mos lejoni fëmijët të përdorin telefonin dhe/ose të luajnë me telefon dhe aksesore pa mbikëqyrje.

Nëse telefoni ka një kapak që hiqet, kini parasysh se telefoni mund të përmbajnë lëndë të cilat mund të krijojnë një reaksion alergjik.

Nëse telefoni juaj është një pajisje e vetme, kapaku i pasëm dhe bateria nuk mund të c'montohen. Nëse c'montoni telefonin garancia del jashtë fuqie. C'montimi i telefonit mund të dëmtojë baterinë dhe mund të shkaktojë rrjedhje të lëndëve që mund të krijojnë një reaksion alergjik.

Gjithmonë përdoreni me kujdes telefonin dhe aksesoret e tij dhe mbajini në një vend të pastër dhe pa pluhur.

Mos lejoni që telefoni juaj të jetë i ekspozuar ndaj motit të pafavorshëm ose të kushteve mjedisore (njomësi, lagështi, shi, infiltrim lëngjesh, pluhur, ajri i detit, etj). Kufiri i temperaturës së funksionimit i rekomanduar nga prodhuesi është nga 0°C (32°F) në 40°C (104°F).

Mbi 40°C (104°F) leximi i ekranit të telefonit mund të jetë i dobët, megjithëse kjo është e përkohshme dhe jo serioze.

Ka mundësi që thirrja e numrave të emergjencës mos të jetë e disponueshme në të gjitha rrejetet. Mos u mbështesni kurrë të celulari juaj për thirrje emergjence.

Mos e hapni, zbërtheni apo të mundoheni ta riparoni vetë telefonin tuaj celular.

Mos e hidhni, flakni apo thyeni telefonin tuaj celular.

Për të shmangur ndonjë plagosje mos e përdorni telefonin nëse xhami i ekranit është i demtuar, i krisur ose i thyer.

Mos e lyeni atë.

Përdorni vetëm bateri, karikues baterie, dhe aksesore të cilët janë të rekomanduar nga TCL Communication Ltd. dhe degët e saj dhe që janë të përshtatshëm me modelin e telefonit tuaj. TCL Communication Ltd. dhe degët e saj refuzojnë çdo përgjegjësi për dëmtime të shaktuara nga përdorimi i karikuesve apo baterive të tjera.

Kujtohuni të bëni kopje rezervë ose ruani një regjistrim të shkruar për të gjithë informacionin e rëndësishëm të ruajtur në telefonin tuaj.

Disa njerëz mund të pësojnë kriza epileptike apo gjendje të fikëti kur ekspozohen ndaj blicit, ose kur luajnë videoljërë. Këto kriza apo verbime mund të ndodhin edhe nëse një person nuk ka pasur kriza apo verbime më parë. Nëse ke vuajtur më parë nga kriza apo gjendje të fikëti, ose nëse ke një historik në familje me ngjarje të tilla, konsultohu me doktorin përpara se të luash me videoljërë apo të aktivizosh veçoritë e blicit në telefon.

Prindërit duhet të monitorojnë përdorimin nga fëmijët e tyre të lojërave video apo të veçorive të tjera që përmbajnë blic e telefonin e tyre. Të gjithë njerëzit duhet të ndërpresin përdorimin dhe të konsultohen me doktorin nëse ndonjë nga simptomat e mëposhtme ndodhin: konvulsione, dridhje sysh ose muskujsh, humbje ndërgjegjësimiti, lëvizje të pavullnetshme, ose mos orientim. Për të kufizuar shfaqjen e këtyre simptomave, ju lutemi merrni masat e sigurisë që vijojnë:

- Mos luani ose mos përdorni tiparet e blicit nëse jeni i lodhur apo keni nevojë të flini.
- Bëni një pushim minimumi prej 15 minutash çdo orë.
- Luani në një dhomë ku të gjitha dritat janë të ndezura.
- Luani në distancën më të largët të mundshme nga ekrani.

- Nëse duart tuaja, kyçet, ose krahët lodhen ose lëndohen ndërkohë që luani, ndaloni dhe pushoni për disa orë përpara se të luani përsëri.

- Nëse vazhdoni të keni lëndime duarsh, kyçesh, apo krahësh gjatë ose pas lojës, ndaloni lojën dhe shkoni te doktori.

Kur luan lojëra në telefon, mund të provosh herë pas here mungesë komoditeti në duart, krahët, shpatullat, qafën apo pjesë të tjera të trupit. Ndiqni instruksionet për të shmangur probleme si inflamacion të muskulit të gilcës, sindromës së tunelit të kyçit, ose çrregullimeve të tjera të muskujve apo skeletit.

• **Deklarata e privatësisë e përdorimit të pajisjes**

Nëse e lidhni pajisjen me rrjete ose pajisje të tjera (si për shembull, Wi-Fi, Bluetooth, NFC ose me ndonjë metodë tjetër), ju lutemi mbani parasysh se disa prej të dhënave tuaja personale mund të ndahen me to. Është përgjegjësia juaj t'i mbroni të dhënat tuaja personale, të mos i ndani me pajisje të paautorizuara ose pajisje të palëve të treta, që janë lidhur me pajisjen tuaj. Për produktet me veçori Wi-Fi, lidhuni vetëm me rrjete Wi-Fi të besuara. Gjithashtu, kur e përdorni produktin si hotspot (aty ku është i disponueshëm), sigurohuni që rrjeti juaj të jetë i mbrojtur. Këto masa paraprake do t'ju ndihmojnë të mos lejoni hyrje të paautorizuara në telefon. Produkti mund të ruajë informacion personal në vende të ndryshme, si për shembull në kartën SIM, në kartën e memories dhe në memorien e brendshme. Sigurohuni të hiqni ose fshini të gjithë informacionin personal para se ta ricikloni, ktheni ose falni produktin. Zgjidhni me kujdes aplikacionet dhe përditësimet tuaja, dhe instaloni vetëm nga burime të besuara, sepse disa aplikacione të palëve të treta mund të ndikojnë te performanca e produktit tuaj dhe/ose të kenë akses në informacionet private, si detajet e llogarisë, të dhënat e telefonatave, detaje të vendndodhjeve dhe burimet e rrjetit. Ne nuk mbajmë përgjegjësi për këto praktika privatësie ose sigurie të palëve të treta.

Të gjitha të dhënat personale që ndani me TCL Communication Ltd. do të trajtohen sipas njoftimit tonë për privatësinë. Mund ta shikoni njoftimin tonë për privatësinë duke vizituar faqen tonë të internetit: <https://www.tcl.com/content/legal-notice/country-list.html>

• **PRIVATËSIA**

Ju lutem vini re se ju duhet të respektoni ligjet dhe rregullat në fuqi në shtetin tuaj dhe shtete të tjera ku ju do të përdorni telefonin tuaj celular në lidhje me bërje fotografish dhe regjistrim zëri me telefonin tuaj celular. Sipas këtyre ligjeve dhe rregullave, mund të jetë rreptësisht e ndaluar të bësh fotografi dhe/ose të regjistrosht zërin e njerëzve të tjerë apo attributeve personale të tyre, si dhe të kopjosh ose ti shpërndash ato, pasi kjo mund të konsiderohet si shkelje e privatësisë. Është përgjegjësia vetëm e përdoruesit të garantojë që autorizimi paraprak është arritur, nëse nevojitet, në mënyrë që të regjistrojë biseda private ose sekrete apo të bëjë foto të një personi tjetër; prodhuesi, shitësi ose pala shitëse i telefonit tuaj (përfshirë operatorin) heqin dorë nga çdo përgjegjësi e cila vjen nga përdorimi jo i duhur i telefonit tuaj.

• BATERIA

Duke pasur parasysh rregulloret e fluturimit, bateria e telefonit nuk është e karikuar. Karikoje atë para përdorimit të parë.

Zbatoni masat paraprake të mëposhtme:

- Mos u përpiqni të hapni baterinë (për shkak të rrezikut të tymit toksik dhe djegies).
- Për pajisjet me bateri që nuk mund të hiqen, mos u mundoni ta nxirrni ose ndërroni baterinë.
- Mos e shponi, çmontoni ose shkaktoni qark të shkurtër në bateri.
- Për pajisjet me një trup të vetëm, mos u mundoni ta hapni ose shponi kapakun e pasmë.
- Mos e digjini apo hidhni baterinë ose telefonin e përdorur në koshat e plehrave të shtëpisë ose mos e ruaj atë në temperatura mbi 60°C.

Telefoni dhe bateria duhet të hidhen në përputhje me rregulloret mjedisore vendore në fuqi.



Ky simbol në telefonin tuaj, në bateri dhe aksesorë do të thotë se këto produkte duhen dërguar në pikat e grumbullimit në fund të jetës së tyre:

- Qendrat e mbetjeve të bashkisë me kazanë specifike për këto lloje pajisjesh
- Koshat e grumbullimit në pikat e shitjes.

Ato më pas duhet të riciklohen, duke parandaluar që lendet të perhapen në mjedis dhe në mënyrë që përbërësit e tyre të mund të ripërdoren.

Në shtetet e Bashkimit Evropian:

Pikat e grumbullimit janë të arritshme pa pagesë.

Të gjitha produktet me këtë shenjë duhen dërguar në këto pika grumbullimi.

Në shtetet jashtë Bashkimit Evropian:

Artikujt e pajisjeve me këtë simbol nuk duhen hedhur në kazanët e zakonshëm nëse në shtetin ose rajonin tuaj ka fabrika të përshtatshme grumbullimi dhe riciklimi; përkundrazi ato duhet të dërgohen në pikat e grumbullimit që të riciklohen.

KUJDES: RREZIK SHPËRTHIMI NËSE BATERI ANDËRROHET ME NJË BATERI TJETËR TË NJË LLOJI TË GABUAR. HIDHINI BATERITË E PËRDORURA NË PËRPUTHJE ME INSTRUKSIONET.

• KARIKUESIT

Karikuesit kryesorë do të funksionojnë në një temperaturë rreth: 0°C (32°F) deri në 40°C (104°F).

Karikuesit e projektuar për telefonin tuaj plotësojnë standardin për sigurinë e informacionit të pajisjeve të teknologjisë dhe zyrës së përdorimit të pajisjeve. Janë gjithashtu të pajtueshëm me direktivën për ndërtimin ekologjik 2009/125/EC. Sipas specifikimeve elektrike të ndryshme të zbatimit, një karikues i blerë në një juridiksion mund të mos punojë në një juridiksion tjetër. Ata duhet të përdoren vetëm për këtë qëllim.

Modeli: QC13

Tensioni i hyrjes: 100~240 V

Frekuenca e hyrjes AC: 50/60 Hz

Tensioni i daljes: 5.0 V/9.0 V/12.0 V

Rryma e daljes: 3.0 A/2.0 A/1.5 A

Fuqia e daljes: 15.0 W/18.0 W/18.0 W

Efikasiteti aktiv mesatar: 81.4 %

Efikasiteti në ngarkesë të ulët (10%): 71.5 %

Konsumi i energjisë pa ngarkesë: 0.1 W

Valët E Radios.....

Dëshmia e pershtatjes me kriteret ndërkombëtare (ICNIRP) ose me Direktivat Evropiane 2014/53/EU (RED) është e nevojshme për të gjithë modelet e telefonave celularë përpara se ato të hidhen në treg. Mbrojtja e shëndetit dhe siguria për përdoruesin dhe për çdo person tjetër është një kërkesë thelbësore e këtyre kriterëve ose kësaj direktive.

KJO PAJISJE PËRMBUSH UDHËZIMET NDËRKOMBËTARE PËR EKSPOZIMIN NDAJ VALËVE TË RADIOS

Pajisja juaj celulare është një radio transmetuese dhe radio marrëse. Ajo është projektuar të mos kapërcejë kufijtë e ekspozimit ndaj valëve të radios (fushave elektromagnetike të frekuencave të radios) të rekomanduara nga udhëzimet ndërkombëtare. Këto udhëzime janë hartuar nga organizata e pavarur shkencore (ICNIRP) dhe përmbajnë kufijtë e sigurisë të përcaktuar për të garantuar mbrojtjen e të gjithë personave, pavarësisht moshës dhe gjendjes shëndetësore.

Udhëzimet e ekspozimit ndaj valëve të radios përdorin një njësi matëse të njohur si koeficienti specifik i absorbimit, ose SAR. Limiti SAR për pajisjet celulare është 2 W/kg për SAR në kokë dhe SAR në trup, dhe 4 W/kg për SAR në gjymtyrë.

Testet për SAR janë kryer duke përdorur pozicionet standarte operative me transmetimin e pajisjes në nivelin më të lartë të certifikuar në të gjithë bandat e frekuencave të provuara. Vlerat më të larta SAR sipas udhëzimeve të ICNIRP për këtë model pajisje janë:

Maksimumi SAR për këtë model dhe kushtet sipas të cilave ishte regjistruar		
Treguesi SAR per koken	LTE Band 38 + Wi-Fi 2,4GHz	1,22 W/kg
Treguesi SAR per trupin (5 mm)	GSM 1800MHz + Wi-Fi 2,4GHz	1,35 W/kg
SAR në gjymtyrë (0 mm)	GSM 1800MHz + Wi-Fi 2,4GHz	2,92 W/kg

Gjatë përdorimit, vlerat aktuale SAR për këtë pajisje janë zakonisht edhe më poshtë se vlerat e deklaruara më sipër. Kjo është sepse, për qëllimin e efikasitetit së sistemit dhe për të minimizuar interferencën në rrjet, fuqia operative e pajisjes suaj celulare është ulur automatikisht kur e gjithë fuqia nuk është e nevojshme për telefonatën. Sa më e ulët të jetë energjia e nxjerrë nga pajisja, aq më e vogël është vlera SAR.

Testime SAR per trupin janë bërë në distanca të ndara prej 5 mm. Për të përmbushur udhëzimet për ekspozimin ndaj RF gjatë funksionimit të telefonit në trup, pajisja duhet të jetë e pozicionuar të paktën këtë distancë larg nga trupi.

Nëse nuk jeni duke përdorur një aksesori të aprovuar sigurohuni që çfarëdo produkti që po përdoret nuk përmban metal dhe pozicioni i telefonit të jetë larg trupit në distancën e treguar.

Organizata të tilla si Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Administrata Amerikane për Ushqimin dhe Barnat kanë deklaruar se njerëzit që janë të shqetësuar dhe duan të reduktojnë ekspozimin e tyre mund të përdorin një handsfree që ta mbajnë telefonin larg nga koka dhe trupi gjatë thirrjeve të telefonatave, ose të reduktojnë kohën që kalojnë në telefon. Për më shumë informacion ju mund të vizitoni faqen zyrtare tcl.com

Informacion shtesë rreth fushave elektromagnetike dhe shëndetit publik janë të mundshme në faqen zyrtare që vijon: <http://www.who.int/peh-emf>.

Telefoni juaj është i pajisur me një antenë/ Për funksion sa më të mirë, ju duhet ta shmangni ose pakësoni prekjeve të saj.

Meqë pajisjet celulare ofrojnë një gamë funksionesh, ata mund të përdoren në pozicione të tjera përveç se përkundrejt veshit tuaj. Në rrethana të tilla pajisja do të jetë në përputhje me udhëzimet kur përdoret me kufje ose kabell usb të dhënash. Nëse po përdorni aksesori tjetër, sigurohuni që produkti që po përdoret të mos përmbajë metale dhe që poziciononi i telefonit të jetë së paku 5 mm larg trupit.

Licencat.....



Logoja microSD është markë tregtare.



Logot dhe markat e fjalës Bluetooth janë pronë e Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga TCL Communication Ltd. dhe filialet e saj bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin zotëruesve të tyre përkatës.

TCL T774H ID-ja e deklaratës Bluetooth D054292



Logoja e Wi-Fi është një markë e certifikuar e Wi-Fi Alliance.

Kjo pajisje mund të përdoret në të gjitha vendet evropiane.

Brezi 5150-5350 MHz është i kufizuar vetëm për përdorim të brendshëm për shtetet e mëposhtme:

BE	BG	CZ	DK	DE	EE	IE	EL	ES
FR	HR	IT	CY	LV	LT	LU	HU	MT
NL	AT	PL	PT	RO	SI	SK	FI	SE
NO	IS	LI	CH	TR	UK (NI)			

Google, logoja e Google, Android, logoja Android, Google Search™, Google Maps™, Gmail™, YouTube, Google Play Store dhe Hangouts™ janë marka tregtare të Google Inc.

Roboti Android është riprodhuar ose modifikuar nga puna e krijuar dhe e publikuar nga Google dhe përdoret sipas kushteve të përshkruara në licencën Creative Commons 3.0 Attribution (teksti shfaqet kur prek **Informacioni ligjore i Google te Konfigurimet > Sistemi > Rreth telefonit > Informacioni ligjor**) ⁽¹⁾.

Keni blerë një produkt që përdor programe me burime të hapura (<http://opensource.org/>) (<http://opensource.org/>) mtd, msdosfs, netfilter/iptables dhe initrd në kodin e objektit dhe programe të tjera me burim të hapur, të licencuara me licencën GNU General Public Licence dhe Apache Licence.

Brënda një periudhe prej tre vitësh nga shpërndarja e këtij produkti nga TCL Communication Ltd, ne mund të ofrojmë një kopje të plotë të kodeve përkatëse burimore, me kërkesën tënde.

Mund t'i shkarkosh kodet burimore nga adresa <https://sourceforge.net/projects/tcl-mobile/files/>. Sigurimi i kodit burimor ofrohet falas nëpërmjet internetit.

Theksojmë se garancia për përdoruesin e fundit për shkeljen e DPI është e kufizuar vetëm për BE-në/ZEE-në/Zvicrën.

Nëse dhe deri në masën që produkti eksportohet, merrt apo përdoret nga konsumatori përfundimtar ose përdoruesi i fundit jashtë BE-së/ZEE-së/Zvicrës çdo përgjegjësi, garanci ose zhdëmtim i prodhuesit dhe furnizuesit të tij në lidhje me Produktin skadon (duke përfshirë çdo dëmshpërblim në lidhje me shkeljen e DPI-së).

Informacion i përgjithshëm

- **Adresa e internetit:** tcl.com
- **Linja e hapur telefonike:** shko te faqja jonë zyrtare <https://www.tcl.com/global/en/mobile-support/hotline&service-center.html>
- **Prodhuesi:** TCL Communication Ltd.
- **Adresa:** 5/F, Building 22E, 22 Science Park East Avenue, Hong Kong Science Park, Shatin, NT, Hong Kong
- **Shtegu i etiketimit elektronik:** Prek **Konfigurimet > Sistemi > Rregullat dhe siguria** ose shtyp *#07#, mund të gjesh më shumë informacion rreth etiketimit ⁽²⁾.

Në faqen tonë të internetit, do të gjesh sektorin tonë të PESH (Pyetjet e shpeshta). Gjithashtu mund të na kontaktosh me email për të pyetur për çdo pyetje që mund të keni.

Kjo pajisje radioje funksionon në brezat e frekuencës dhe fuqinë maksimale të radio-frekuencës si më poshtë:

GSM 900: 33,5 dBm

GSM 1800: 30 dBm

UMTS B1 (2100): 24 dBm

UMTS B8 (900): 24,5 dBm

LTE FDD B1/3/7/8/20/28 (2100/1800/2600/900/800/700): 24,5 dBm

LTE TDD B38 (2600): 24,5 dBm

LTE TDD B40 (2300): 23,6 dBm

⁽¹⁾ Mund të mos jenë të disponueshme në të gjithë shtetet.

⁽²⁾ Varet nga shtetet.

Bluetooth Brezi 2,4 GHz: 9,33 dBm
Bluetooth LE Brezi 2,4 GHz: 4,67 dBm
802.11 b/g/n Brezi 2,4 GHz: 17.21 dBm
802.11 a/n/ac Brezi 5,0 GHz: 15,15 dBm
NFC 13.56 MHz: -18.045 dBuA/m në 10m

• Informacioni Rregullues

Përmes kësaj deklarate, TCL Communication Ltd. deklaroi se pajisja e radios e llojit **TCL T774H** është në përputhje me Direktivën 2014/53/EU.

Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit të BE-së disponohet në adresën e mëposhtme të internetit: www.tcl.com/global/en/service-support-mobile/eu-doc.html

• Informacion Shtesë

Përshkrimi i aksesoreve dhe komponentëve, duke përfshirë softuerët, të cilët u lejojnë pajisjeve të radios që të funksionojnë sipas qëllimit të tyre, mund të merret në tekstin e plotë të deklaratës së konformitetit të BE-së në adresën e mëposhtme të internetit: www.tcl.com/global/en/service-support-mobile/eu-doc.html

• Modaliteti i rehatisë së syve

Modaliteti i rehatisë së syve filtron dritën blu dhe rregullon temperaturën e ngjyrave të ekranit për të pakësuar lodhjen e syve.

Prekni **Cilësimet > Ekranit > Modaliteti i rehatisë së syve** për ta vendosur.

Këshilla:

- Mos e përdorni pajisjen për periudha të gjata, rekomandohet që të pushoni 10 minuta çdo orë.
- Kur pushoni, ju lutemi shikoni diku tjetër ose bëni ushtrime të syve për t'u çlodhur.

Mbrojtja ndaj vjedhjes ⁽¹⁾

Telefoni juaj identifikohet nga një IMEI (numër serial telefoni) i treguar në etiketën e paketimit dhe në memorien e telefonit. Ne rekomandojmë që ta mbash shënim numrin herën e parë që përdor telefonin, duke shtypur ***#06#** dhe ta ruash atë në vend të sigurt. Ky numër mund të kërkohet nga policia ose operatori nëse të vjedhin telefonin. Ky numër bën të mundur që celulari të bllokohet, duke penguar përdorimin e tij nga një person tjetër, qoftë edhe me kartë tjetër SIM.

Deklarim për mos-mbajtje përgjegjësie

Midis përshkrimit në manualin e përdoruesit dhe funksionimit të telefonit mund të ketë disa ndryshime, në varësi të versionit të softuerit të telefonit ose të shërbimeve të veçanta të operatorit.

⁽¹⁾ Kontakto me operatorin e rrjetit për të kontrolluar disponueshmërinë e shërbimit.

TCL Communication Ltd. nuk do të jetë përgjegjës për këto ndryshime, nëse ka, as për pasojat e tyre të mundshme, përgjegjësia e të cilave do të jetë vetëm e operatorit. Ky telefon mund të përmbajë materiale, duke përfshirë aplikacione dhe programe ose kod burimor, që janë paraqitur nga palë të treta për përfshirje në këtë telefon ("Materialet e palëve të treta"). Të gjithë materialet e palës së tretë në këtë telefon janë dhënë "njëlloj siç janë" pa garanci të çdo lloji, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar. Blerësi pranon se TCL Communication Ltd. ka zbatuar të gjitha detyrimet cilësore që ka për detyrë si prodhues i pajisjeve celulare dhe i telefonave në përputhje me të drejtat e pronësisë intelektuale. TCL Communication Ltd. nuk do të jetë përgjegjës në asnjë fazë për paaftësi ose dështim të funksionimit të materialeve të palëve të treta në këtë telefon ose në ndërveprim me ndonjë telefon tjetër. Në masën maksimale të lejuar nga ligji, TCL Mobile hedh poshtë gjithë përgjegjësinë për çdo kërkesë, padi ose veprim, dhe më specifikisht - por pa u kufizuar me - paditë për shkelje jashtë kontrate, sipas ndonjë teorie të detyrimit, ngritur nga përdorimi, me çdo mjet, ose përpjekje përdorimi, këto materiale të palëve të treta. Për më tepër, materialet aktuale të palëve të treta, të cilat ofrohen pa pagesë nga TCL Communication Ltd., mund të jenë subjekt përditësimi me pagesë dhe përmirësimi në të ardhmen; TCL Communication Ltd. nuk merr parasysh ndonjë përgjegjësi lidhur me kosto shtesë, e cila do të mbulohet ekskluzivisht nga blerësi. TCL Communication Ltd. nuk do të mbajë përgjegjësi për mungesën e disponueshmërisë së ndonjë aplikacioni, pasi disponueshmëria e tij varet nga shteti dhe operatori i blerësit. TCL Communication Ltd. rezervon të drejtën në çdo kohë për të shtuar ose hequr materiale të palëve të treta nga telefonat e saj pa njoftim paraprak; në asnjë rast blerësi nuk mund të konsideroj se kompania TCL Communication Ltd. ka përgjegjësi për këtë heqje.

GARANCIA E KUFIZUAR

- **Të drejta shtesë sipas ligjeve për konsumatorin.**

Si konsumator, ju mund të keni të drejta ligjore (statutore) të cilat janë përveç atyre të përcaktuara në këtë garanci të kufizuar, si për shembull ligjet për konsumatorin të vendit ku jetoni ("Të drejtat e konsumatorit"). Kjo garanci e kufizuar tregon situata të caktuara se në të cilat prodhuesi do të sigurojë ose nuk do të sigurojë një zgjidhje për pajisjen TCL. Kjo garanci e kufizuar nuk kufizon ose nuk përjashton asnjë prej të drejtave TUAJA si konsumator të cilat lidhen me pajisjen TCL.

- **Mbulimi i garancisë së prodhuesit**

Kjo garanci e kufizuar e prodhuesit përcakton përgjegjësitë e garancisë së prodhuesit lidhur me harduerin e markës TCL dhe aksesorët e prodhuar nga prodhuesi ose për interes të prodhuesit.

Prodhuesi i garanton blerësit fillestar si përdorues final të një pajisjeje të re TCL ("juve") se pajisja TCL nuk do të ketë defekte në materiale dhe prodhim gjatë përdorimit normal duke filluar në një periudhë nga data e blerjes për herë të parë nga ju dhe duke vazhduar me periudhën e përcaktuar kohore për çdo lloj pajisjeje TCL që zbatohet ("Periudha e garancisë").

Ju nuk mundeni t'ia transferoni dikujt tjetër këtë garanci të kufizuar.

Periudha e garancisë është treguar më poshtë:

Telefoni TCL dhe bateria e brendshme ⁽¹⁾	24 muaj ⁽²⁾
Aksesorët TCL: USB kablo, karikues, kufje	12 muaj ⁽²⁾

Në rast të ndonjë defekti të telefonit që të pengon nga përdorimi normal i saj, duhet të informosh menjëherë shitësin dhe të paraqitësh telefonin me provën e blerjes.

Nëse defekti konfirmohet nga prodhuesi ose nga servisi i autorizuar prej tij, telefoni ose pjesë të tij ose do të riparohen ose do të ndërrohen, sipas nevojës. Riparimi ose zëvendësimi mund të kryhet duke përdorur komponentë të rinovuar nëpërmjet aparatësh që ofrojnë funksionalitet të njëjtë.

Kjo garanci mbulon kostot e riparimit ose ndërrimit (puna dhe pjesët e këmbimit) por përjashton çdo kosto tjetër.

Kjo garanci nuk do të aplikohet për defekte të telefonit tuaj dhe\ ose aksesorëve për shkak të (pa ndonjë limitim).

- mospërputhje me udhëzimet për përdorimin apo instalimin, ose me standardet teknike dhe të sigurisë të aplikueshme në zonën gjeografike ku është përdorur telefoni juaj;
- lidhja me çfarëdo pajisjeje nuk sigurohet ose nuk rekomandohet nga prodhuesi;
- riparimi i bërë nga individët nuk autorizohet nga prodhuesi ose nga filialet e tij;
- modifikimi, rregullimi ose ndryshimi i softuerit ose harduerit të kryer nga individë që nuk janë të autorizuar nga prodhuesi;
- moti me shi, rrufetë, zjarri, lagështia, depërtimi i lëngjeve ose ushqimeve, produktet kimike, ndërhyrja ose shkarkimi i skedarëve/softuerëve keqdashës (malware), përplasjet, tensioni i lartë, gërryerja, oksidimi.

Telefoni nuk do të riparohet në rast se etiketat apo numrat serial (IMEI) janë hequr ose ndryshuar.

Në asnjë rast prodhuesi apo ndonjë nga filialet e saj nuk do të jetë përgjegjës për dëmet indirekte, të rastësishme ose rrjedhimore të çfarëdo natyre, duke përfshirë, por jo vetëm, humbjet ose dëmtimet tregtare apo financiare, humbjet e të dhënave apo humbjen e imazhit deri në masën e plotë që ato dëmtime mund të hidhen poshtë me ligj.

Disa vende/shtete nuk lejojnë përjashtimin ose kufizimin e dëmeve indirekte, të rastësishme ose rrjedhimore, ose kufizimet në kohëzgjatjen e garancive të nënkuptuara, kështu që kufizimet ose përjashtimet mund të mos zbatohen për ju.

(1) Jetëgjatësia e një baterie të rikarikueshme telefoni në lidhje me kohën e bisedës, kohën e gatishmërisë dhe jetëgjatësinë totale të shërbimit, do të varet nga kushtet e përdorimit dhe konfigurimi i rrjetit.

(2) Periudha e garancisë mund të ndryshojë në varësi të shtetit të blerjes dhe/ose kanalit të blerjes.

Nëse pajisja juaj TCL kthehet gjatë periudhës së garancisë, por pajisja juaj TCL nuk mbulohet sipas kësaj garancie të kufizuar, mund të aplikohen rregulla dhe tarifa për çdo riparim ose përpunim të kryer.

Nëse nuk jetoni në vendin ku ju është shitur fillimisht pajisja TCL, atëherë

- (a) riparimi ose shërbimi i garancisë mund të mos jetë i mundur;
- (b) mund t'ju kërkohet të pranoni rregullat dhe/ose të paguani kosto të caktuara (duke përfshirë, por jo vetëm, kostot e transportit dhe lëvizjes;
- (c) riparimi ose shërbimi i garancisë, nëse është i mundshëm, mund të zgjatë më shumë se normalisht.

• **Arkivoni të dhënat tuaja**

Duhet t'i arkivoni rregullisht të dhënat, skedarët, aplikacionet dhe parametrat tuaja si masë mbrojtëse kundër problemeve të mundshme operacionale para se ta ktheni pajisjen TCL. Arkivimi i të dhënave është përgjegjësia juaj dhe nuk është përgjegjësia e prodhuesit, shitësit tek i cili keni blerë pajisjen TCL, apo e servisit të autorizuar nga prodhuesi tek i cili mund të keni bërë servis, (riparime ose ndërrim të pajisjes TCL).

Nëse ju duhet ta dërgoni/lini pajisjen TCL për servis, ju rekomandojmë ta shkëputni pajisjen nga çdo pajisje tjetër e jashtme (kartë memorieje, kartë SIM) dhe t'i hiqni të dhënat personale dhe konfidenciale para se ta dërgoni/lini pajisjen TCL. Gjatë servisit (riparimit ose ndërrimit), përmbajtjet në pajisjen tuaj TCL mund të fshihen, riformatohen ose konfigurohen siç ishin në gjendjen kur është blerë (subjekt i përditësimeve dhe përmirësimeve të softuerit) dhe pajisjet e jashtme që janë hequr mund të mos ju kthehen juve.

Kjo garanci e kufizuar nuk mbulon arkivimin, rikuperimin ose riinstalimin e të dhënave, skedarëve dhe aplikacioneve tuaja në pajisjen TCL.

Prodhuesi: TCL Communication Ltd.

TCL 20_L